



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 154, datë 14.04.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shumë mirë”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

EKSTRAKT

RAPORT
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARES
{...} (MEMA)
VITI 2019

POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtarja, në bazë të kategorisë së çështjes (*padi themeli ose kërkesë administrative*), përcakton në fillim të pjesës përshkuese arsytuese të vendimit, faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë gjykimit. Në dokumentet ligjore rezulton një pjesë e ndarë në aspektin vizual për përcaktimin “*rrethanave të faktit*”, të cilat janë të integruara me provat e administruara, duke u evidentuar lehtësisht. Paraqitja e fakteve të çështjes, duke iu referuar vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja apo të përzgjedhura me short, bëhet duke iu referuar përmbajtjes së kërkesë padisë, shpjegimeve të palëve në gjykim dhe provave shkresore të administruara në seancë gjyqësore. Analiza e rrethanave të faktit bëhet në mënyrë të qartë, të plotë dhe mbi bazën e një rendi kronologjik.

Provat e paraqitura nga palët nuk parashtrihen të ndara në vendim, por janë të integruara dhe të evidentueshme në mbështetje të rrethanave të faktit. Elementë të këtyre të fundit, gjenden të pasqyruar dhe në pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të pasqyruara në mënyrë të ndarë e të dallueshme për secilën prej tyre.

Pas përshkrimit të detajuar të fakteve të çështjes, në 7 vendimet e analizuara, në të cilat është disponuar me vendim përfundimtar, elementë të faktit të provuar bëhen pjesë e analizës ligjore dhe konkluzionit të gjykatës. Vetëm në një çështje e cila ka përfunduar me vendim jo përfundimtar për pushimin e çështjes, përshkrimi i fakteve nuk ka qenë i nevojshëm, pasi për rrethana procedurale (paditësi ka hequr dorë nga gjykimi), është disponuar me vendim për pushimin e gjykimit të çështjes.¹

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, me përjashtim të vendimit jo përfundimtar, gjyqtarja përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së fakteve të çështjes, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe referimit në dispozitat ligjore.

¹ Vendimi nr.391, datë 14.05.2019

Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet në mënyrë të qartë dhe të shprehur, bazuar në identifikimin e shkakut ligjor të padisë ose kërkesës (*mosmarrëveshje me shkak ligjor nenin 609 të K.Pr.Civile, mosmarrëveshje administrative lindur në kuadër të zbatimit të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, akteve nënligjore në zbatim të tij, ligjit nr.8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore”, mosmarrëveshje administrative e lindur në kuadër të zbatimit të legjislacionit për privatizimin e ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore, etj.*) Në këtë kontekst, në lidhje me detyrimin e gjykatës për përcaktimin e saktë të shkakut ligjor të padisë, gjyqtarja referon në Vendimin Unifikues 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin administrativ ose titullin ekzekutiv, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, detyrimin e organit administrativ për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ. Kjo analizë i shërben prezantimit të qartë të natyrës së konfliktit si dhe orienton në vijim arsyetimin ligjor.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në 8 vendimet e vëzhguara, rezulton se pas pasqyrimin të fakteve të çështjeve dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja referon dhe citon dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht, në 8 vendimet e analizuara, identifikohen, referohen dhe citohen dispozitat ligjore si më poshtë :

- nenet 6 dhe 309 të K.Pr.Civile lidhur me detyrimin e gjykatës për t’u shprehur mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet si dhe çmuarjen e provave sipas bindjes së brendshme;
- nenet 15, 16, 17, 37 të ligjit 49/2019 mbi të drejtën e ngritjes së padisë, objektin e padisë, kushtet për shterimin e ankimit administrativ dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes;
- nenet 109, 113, 108 të K.Pr.Administrative mbi paligjshmërinë e aktit administrativ, procedurën dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit;
- nenet 2, 17, 37 të ligjit 49/2019 mbi dhënien e përkufizimeve të veprimit dhe mosveprimit administrativ, objektit të padisë dhe kufijve të shqyrtimit të çështjes;
- nenet 25, 34/2, 39 i ligjit 49/2012, si dhe nenet 158 dhe 299 të K.Pr.Civile, në lidhje me veprimet përgatitore të gjyqtarit, pasojave juridike të mosparaqitjes së palëve si dhe rastet e disponimit me vendim jo përfundimtar nga gjykata administrative²;
- nenet 22, 24, 46 të ligjit 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenin 131 të Kodit Civil si dhe nenin 609 të K.Pr.Civile, lidhur me kundërvajtjet administrative, parashkrimin e dënimit administrativ, ndërprerjen e parashkrimit, pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv³;
- nenet 17, 37, 116, të K.Pr.Administrative lidhur me pavlefshmërinë absolute të akteve administrative⁴;
- Nenet 510, 511 i K.Pr.Civile lidhur me titujt ekzekutiv⁵;

Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- ligji nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” ;

² Vendim nr.391, datë 14.05.2019

³ Vendim nr.737, datë 31.07.2019

⁴ Vendim nr.891, datë 21.10.2019

⁵ Vendim nr. 173, datë 19.03.2019

- ligji nr.10279, datë 20.05. 2010 “Për kundërvajtjet administrative” ;
- ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë me qëllim shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve që kundërshtohen⁶;
- nenin 21 të ligjit nr.9698/1993 lidhur me të drejtën e parablerjes së objektit shtetëror që privatizohet dhe nenin 27 të VKM-së nr.428, datë 09.06.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes”, nenin 5 të VKM nr.52, datë 07.02.2007 “Për përcaktimin e procedurave dhe afateve të komunikimit, ndërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës”⁷;
- nenet 2, 44 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, lidhur me fushën e zbatimit të ligjit si dhe të drejtën e ankimit⁸;
- nenin 245 pika 4 e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
- ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 9639, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” mbi pavlefshmërinë, paligjshmërinë e aktit administrativ⁹.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimin nr.129, datë 27.02.2019, përzgjedhur nga gjyqtarja për vlerësim, rezulton të jetë trajtuar konflikti i normave duke vlerësuar se në rastin e konkurrimit të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” me ligje të tjera (duke specifikuar se në pjesën më të madhe të rasteve janë ligjet për privatizimin e objekteve shtetërore), prioritet i jepet të parit.

KONKLUZIONI:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Ajo ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore, që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi. Kur është rasti, gjyqtarja identifikon konfliktin e normave dhe arsyeton mbi atë që prevalon ndaj tjetrës në zgjidhjen e çështjes. Rregulli dhe fakti janë të lidhur ngushtësisht dhe në dobi të njëri-tjetrit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në të gjitha vendimet gjyqësore dispozitat ligjore të evidentuara si të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, shoqërohen me interpretimin e kuptimit dhe qëllimit të tyre, para aplikimit mbi faktin konkret në shërbim të të cilit ato analizohen.

⁶ Vendim nr.346, datë 02.05.2019, vendim nr.285, datë 17.04.2019

⁷ Vendim nr.129, datë 27.02.2019

⁸ Vendim nr.891, datë 21.10.2019

⁹ Vendim nr.972, datë 07.11.2019

Në lidhje me normat procedurale, gjyqtarja ka interpretuar dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- interpretim i konceptin juridik të provës në raport me mënyrën e marrjes dhe pranimit të saj në një gjykim civil, referuar neneve 11 dhe 213 të K.Pr.Civile si dhe Vendimit Nr. 45, datë 23.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin është analizuar çmuarja e provave, fuqia provuese e aktit të ekspertimit si provë dhe fuqia provuese e tij në raport llojet e tjera të provave¹⁰.
- interpretim i neneve 158 dhe 299 të K.Pr.Civile, në lidhje me veprimet përgatitore të gjyqtarit, pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve si dhe rastet e disponimit me vendim jo përfundimtar nga gjykata administrative¹¹.
- interpretim i nenit 32 të K.Pr.Civile, në funksion të analizimit të konceptit të legjitimitetit aktiv¹².
- Interpretim i nenit 7/f/b dhe 11 të ligjit nr.49/2012 për të konstatuar kryesisht kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes, apo nenit 17/1/ç të ligjit 49/2012, me qëllim identifikimin e mjetit procedural me të cilin pala paditëse i drejtohet gjykatës¹³.

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, në të gjitha vendimet gjyqësore gjyqtarja ndalet në interpretimin ligjor të dispozitës, duke i dhënë përgjigje edhe pretendimeve të palëve në rastet kur ato kanë qasje tjetër ndaj qëllimit të ligjit. Konkretisht rezulton të jenë interpretuar dispozitat ligjore dhe nënligjore lidhur me :

- pavlefshmërinë relative dhe ligjshmërinë e akteve administrative, sipas neneve 118 dhe 109 të K.Pr.Administrative si dhe interpretimi i nenit 116 të K.Pr.Administrative, me qëllim hetimin e ekzistencës së shkaqeve ligjore të pavlefshmërisë absolute të akteve administrative¹⁴.
- interpretimin e nenit 21 të ligjit nr. 9698/1993 si dhe nenit 8/1 të ligjit 9235/2004 me qëllim analizimin e të drejtës së parablerjes së objektit shtetëror që privatizohet nga subjekti i shpronësuar¹⁵.
- interpretimin e nenit 609 të K.Pr.Civile në funksion të përcaktimit të mosmarrëveshjes objekt gjykimi dhe natyrës së mjetit procedural me të cilin pala paditëse i është drejtuar gjykatës. Në këtë kontekst gjyqtarja interpreton ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr. 114/2016 në raport me nenin 609 të K.Pr.Civile, me qëllim përcaktimin e ligjit të zbatueshëm¹⁶.
- interpretimin e nenit 131 të Kodit Civil dhe nenit 46 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010, duke analizuar ndërprerjen e parashkrimit, pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe parashkrimin e dënimit administrativ të nxjerrë nga organi i administratës publike. Po ashtu interpretohet neni 44 i ligjit 1029/2010 në raport me nenin 46 të po këtij ligji për të konstatuar parashkrimin ose jo të ekzekutimit të dënimit administrativ dhe ekzistencën e detyrimit¹⁷.
- interpretimin e nenit 608 të Kodit Civil, në funksion të kërkimit për shpërblimin e dëmit¹⁸.

¹⁰ Vendimin nr. 346, datë 02.05.2019, përzgjedhur nga gjyqtarja

¹¹ Vendim nr.391, datë 14.05.2019

¹² Vendim nr. 891, datë 21.10.2019

¹³ Vendimi nr. 129, datë 27.02.2019, vendim nr. 891, datë 21.10.2019, vendim nr.285, datë 17.04.2019

¹⁴ Vendimin nr. 129, datë 27.02.2019, vendimi nr. 891, datë 21.10.2019, vendimin nr. 972, datë 07.11.2019.

¹⁵ Vendim nr. 129, datë 27.02.2019

¹⁶ Vendimin nr.737, datë 31.07.2019

¹⁷ Vendimin nr.737, datë 31.07.2019

¹⁸ Vendimi nr. 891, datë 21.10.2019

- interpretim i neneve 4, 14 dhe 15 të K.Pr.Administrative lidhur me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe parimin e përgjegjësisë¹⁹.
- interpretimin e neneve 4, 9, 14, 15 të K.Pr.Administrative, me qëllim analizimin e parimit të ligjshmërisë dhe përgjegjësisë, duke argumentuar detyrimin e administratës të veprave në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe të përmbush detyrimet që përcaktohen në to²⁰.

Në disa nga vendimet janë interpretuar dispozita të akteve nënligjore që gjejnë zbatim. Konkretisht, gjyqtarja:

- interpreton dispozita të VKM-së nr.428, datë 09.06.2010 “*Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes*” me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë në lidhje me procedurat e ndjekura nga ana e organit të administratës publike për privatizimin e pronës në formën e shitjes në ankand²¹.
- interpreton pikën 28 të VKM nr.926, datë 29.12.2014 “*Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes*” duke analizuar se nga ana e palës së paditur bëhet formalizimi me akt noterial i vetëm i atyre kontratave të cilat janë të nënshkruara nga përfaqësues të ish Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe degëve të saj në rrethe (*për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara në vite me përfaqësuesin e ndërmarrjes dhe blerësit e parë të objektit apo ndërmarrjes*), por që janë lidhur jo sipas mënyrës së kërkuar nga ligji (*para noterit*).²².

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, gjyqtarja zbaton parimin e procesit të rregullt ligjor, pa përmendur shprehimisht elementë të këtij parimi, por referuar kontekstit të arsyetimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejt aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, të drejtën e disponimit të padisë, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim...etj.

Parimet e përgjithshme të së drejtës evidentohen dhe analizohen në mbështetje të dispozitave materiale dhe procedurale, duke pasuruar argumentet ligjore në zgjidhjen e çështjes. Në vendimet gjyqësore ka analizë të parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit dhe përgjegjësisë së organit administrativ, referuar neneve 4, 9, 14 dhe 15 të K.Pr.Administrative²³ si dhe atij të “*gjësë së gjykuar*”²⁴. Në një rast është analizuar parimi i zbatimit të ligjit në kohë, duke interpretuar ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr. 114/2016 në raport me nenin 609 të K.Pr.Civile, me qëllim përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në çështjen konkrete²⁵.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, në disa nga vendimet të analizuara, referuar objektit të mosmarrëveshjes, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në lidhje me:

¹⁹ Vendimi nr. 346, datë 02.05.2019

²⁰ Vendimi nr. 129, datë 27.02.2019, vendimi nr. 972, datë 07.11.2019

²¹ Vendimi nr.129, datë 27.02.2019

²² Vendimin nr.285, datë 17.04.2019

²³ Vendimi 346, datë 02.05.2019, vendimin nr. 129, datë 27.02.2019, vendimin nr. 891, datë 21.10.2019, vendim nr. 972, datë 07.11.2019

²⁴ Vendimi nr. 129, datë 27.02.2019 dhe vendimi nr. 891, datë 21.10.2019

²⁵ Vendimi nr.737, datë 31.07.2019

- interpretimin e konceptit juridik të provës në raport me mënyrën e marrjes dhe pranimit të saj në një gjykim civil, referuar neneve 11 dhe 213 të K.Pr.Civile. Në këtë aspekt, gjyqtarja i referohet Vendimit Nr. 45, datë 23.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin është analizuar çmuarja e provave, fuqia provuese e aktit të ekspertimit si provë dhe fuqia provuese e tij në raport llojet e tjera të provave²⁶.
- përcaktimin e saktë të objektit dhe shkakut të mosmarrëveshjes, për të cilin gjyqtarja është referuar në disa raste në Vendimin Unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁷.
- cilësimin e vendimeve të paankimueshme të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si të formës së prerë dhe të ekzekutueshme duke iu referuar vendimit nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese²⁸.
- përcaktimin e shkaqeve për të cilat kërkohet pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, ku gjyqtarja i referohet Vendimit Unifikues nr.00-2012-1816(356), datë 06.07.2012 të Gjykatës së Lartë²⁹.

KONKLUZIONI:

Në tërësi, në të gjitha vendimet përfundimtare të analizuara, gjyqtarja ka interpretuar dispozita të akteve ligjore dhe nënligjore, me natyrë procedurale dhe materiale, duke u referuar në disa raste edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Norma juridike analizohet në çdo komponent të saj, ku evidentohen zberthimi sipas pjesëve përbërëse dhe lidhja e tyre me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qëllimit të normës dhe arsytimit pse ajo identifikohet si ligj i zbatueshëm mbi faktet konkrete. Në procesin e interpretimit të ligjit konsiderohet jo vetëm “gjuha e ligjit”, por edhe qëndrimet që praktika gjyqësore ka pasur në lidhje me interpretimin e normës së caktuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjyimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin. Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës gjyqtarja i përmend ato në arsyetim duke i cituar në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për kuptimin e tyre për lexuesin. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

²⁶ Vendimi nr. 346, datë 02.05.2019

²⁷ Vendim nr. 129, datë 27.02.2019, vendim nr. 891, datë 21.10.2019, vendim nr. 972, datë 07.11.2019

²⁸ Vendim nr. 129, datë 27.02.2019

²⁹ Vendim nr.737, datë 31.07.2019

Gjyqtarja përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor.

Termet teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme dhe të ndryshme nga ajo juridike.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi normale, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, i bën në tërësi vendimet të kuptueshme dhe duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

KONKLUZIONI:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Paragrafët përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila përmbledh përmbajtjen e tij dhe shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuar më parë, por siguron qëndrueshmëri të mendimit, pa ndërprerje të tij dhe e bën mendimin të rrjedhë natyrshëm, si një i tërë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, konstatohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimeve gjyqësore të njëjtën strukturë, e cila është qëndrueshme, e organizuar dhe e standardizuar. Vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin, sipas parashikimeve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile.

Në pjesën hyrëse të vendimit gjen pasqyrim trupi gjykues që ka dhënë vendimin, sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët ndërgjyqëse (me të dhënat për gjeneralitetet, adresën dhe përfaqësimin në gjykatë), objekti i mosmarrëveshjes civile dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë në disa pjesë në të cilën në mënyrë të detajuar ku pasqyrohen :

- (i) faktet e çështjes referuar pretendimeve të palëve si dhe akteve shkresore;

- (ii) pretendimet e palëve, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar argumentet e tyre ;
- (iii) identifikimi i ligjit të zbatueshëm, nëpërmjet të cilit dispozitat citohen dhe vendosen përballë njëra tjetrës ;
- (iv) procesi analitik i vlerësimit të provave, interpretimi abstrakt i ligjit dhe argumentimi i zbatimit të tij mbi faktet e provuara. Analiza e çdo pretendimi përfundon me një konkluzion më vete përmbyllës, tërësia e të cilëve përbën konkluzionin përfundimtar mbi zgjidhjen e çështjes.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, i cili është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkuese–arsyetuese. Dispozitivi përmban disponimin për pranimin ose rrëzimin e padisë, pagimin e shpenzimeve gjyqësore si dhe të drejtën e ankimit dhe afatin e ushtrimit të saj.

KONKLUZIONI:

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ndjek një strukturë përgjithësisht të njëjtë në arsyetimin e vendimeve, të ndarë pjesë të cilat identifikohen nga tituj ose një fjali tematike kryesore. Metoda IRAC (fakti-rregulli-aplikimi i ligjit mbi faktet e provuara-konkluzioni) e përdorur nga gjyqtarja, strukturon qartë mendimin dhe argumentimin logjik, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuar, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet e themelit është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për secilin kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete si dhe lidhjen shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime, lidhur me:

- Analizën e ligjshmërinë së akteve që kundërshtohen në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ, referuar nenit 37 të ligjit 49/2012 si dhe analizën e institutit juridik të *pavlefshmërisë relative të aktit* në funksion të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes³⁰.

³⁰ (vendim nr.346, datë 02.05.2019)

- Analizën e mjetit procedural, kur padia ngrihet për të detyruar një autoritet administrativ për të kryer një veprim administrativ apo për të detyruar organin publik që të mos kryejë një veprim administrativ të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo interesit të paditësit, cilësuar nga gjyqtarja si *padia mandamus*³¹.
- Analizën e të drejtës së parablerjes, si dhe analizimi i procedurës së privatizimit të pronës në formën e shitjes në ankand me qëllim vlerësimin e mënyrës si është proceduar nga ana e palës së paditur/organit publik për privatizimin e pronës³².
- Analizën e institutit juridik të *pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv* si mjet të posaçëm kundër ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Analiza e institutit bëhet e diferencuar referuar llojit të titullit ekzekutiv “akt jashtëgjyqësor” si dhe shkaqeve të pavlefshmërisë.³³
- Analizën e institutit juridik të *ndërprerjes së parashkrimit, pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv* në raport me parashikimin e dispozitës 615/d të K.Pr.Civile, si dhe *parashkrimit të dënimit administrativ të nxjerrë nga organi publik*.³⁴
- Analizën e *pavlefshmërisë absolute të akteve administrative* duke mbajtur qëndrimin se pavlefshmërinë absolute e sjellin shkeljet “thelbësore” të kompetencës, procedurës dhe formës së nxjerrjes së tij nga organi administrativ³⁵.
- Analizën e konceptit juridik të *interesit të ligjshëm në ngritjen e padisë dhe legjitimitetit aktiv* në raport me detyrimin e gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat në fuqi³⁶.
- Analizën e institutit juridik të *titullit ekzekutiv* duke analizuar natyrën referuese të nenit 510 pika e) të K.Pr.Civile³⁷.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor. Shpjegimet dhe prapësimet parashtrohen fillimisht në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsytimit, ndërsa më pas merren në analizë më vetë, të ndërthurura me analizën e provave dhe zbatimin e ligjit. Pretendimet e palëve, qoftë ato në favor të zgjidhje së çështjes ashtu dhe pretendimet e kundërta, marrin një përgjigje të argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

KONKLUZIONI:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Analiza dhe argumentimi logjik ndjek rregullin : fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

³¹ (vendimin nr.129, datë 27.02.2019, vendim nr.285, datë 17.04.2019)

³² (vendimin nr.129, datë 27.02.2019)

³³ (vendim nr.737, datë 31.07.2019)

³⁴ Vendim nr.737, datë 31.07.2019

³⁵ Vendim nr.891, datë 21.10.2019, vendim nr. 972, datë 07.11.2019

³⁶ Vendim nr.737, datë 31.07.2019

³⁷ Vendim nr. 173, datë 19.03.2019

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 15 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin dy kategorive, “administrative me palë kundërshtare” dhe “administrative pa palë kundërshtare”. Duke iu referuar objektit të çështjeve pasqyruar në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet janë me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbareme” për të cilat neni 610 paragrafi i tretë³⁸ i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se çështja duhet të shqyrtohet brenda një afati 20 ditor, dhe me objekt “Sigurim padie”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 28 pika 3³⁹ të ligjit nr. 49/2012 duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë.

Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se nga 15 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 12 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (12 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (15 çështje), sipas një analize vetëm matematikore, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 80 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

³⁸Neni 69 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se “Veprimet e kryerja nga përmbareuesi gjyqësor, në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen sipas parashikimeve të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile.”. Ndërkohë neni 610 paragrafi 3 i K.Pr.C parashikon se :”Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbareuesin gjyqësor.”.

³⁹Neni 28 pika 3 i ligjit nr. 49/2012 « «Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative » parashikon se « «3.Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në rastet e ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. »

Nga kundërshtimet e gjyqtares dhe provat e administruara në seancë dëgjimore rezultonte se 1 çështje e përfshirë në tabela statistikore me objekt “kundërshtim veprimesh përmbarimore” si e gjykuar tej afatit ligjor, ishte padi themeli që nuk kishte lidhje me fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Gjyqtarja parashtronte se në tabelën nr.1, çështja me numër rendor 12 është pasqyruar gabimisht me objektin “kundërshtim veprimesh përmbarimore”. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr.55, datë 04.02.2019 dhe i përket çështjes administrative me palë ndërgjyqjësë; paditës shoqëria “Habili” sh.p.k, palë e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës me objekt “*Kundërshtimin e veprimit administrativ për kalimin e shumës prej 400.000 lekësh për llogari të indekseve 14/a dhe 15/a dhe detyrimin e palës së paditur të më kthejë shumën prej 400.000 lekë, duke mbyllur tatim fitimin e vitit 2016 sipas destinacionit të përcaktuar në mandatet përkatëse*”

Duke zbritur këtë çështje nga numri i çështjeve me afat ligjor, përqindja e çështjeve me afat ligjor të përfunduara jashtë afatit **rezulton 78 %** (11/14 x 100).

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit dhe në kundërshtimet e bëra, gjyqtarja ka parashtruar se në mungesë të një parashikimi ligjor në ligjin e posaçëm 49/2012 në lidhje me afatet ligjore, mund të bëhet referim tek afati 1 vjeçar i përcaktuar në nenin 399/2 të K.Pr.Civile. Gjyqtarja parashtron gjithashtu se vonesat në shqyrtimin e çështjeve kanë ardhur edhe për shkak të volumit të madh të çështjeve, trupës gjyqësore jo të plotë në të cilën ka punuar kjo gjykatë në pjesën më të madhe të kohës së saj, si dhe raste të shpeshta të rritjes së volumit të çështjeve, për shkak të largimit të gjyqtarëve të tjerë, apo transferimit të tyre. Gjithashtu, gjyqtarja ka parashtruar se vonesat në shqyrtimin e çështjeve kanë ardhur edhe për shkak të mënyrës së funksionimit të gjykatës, numrit të madh të çështjeve të ardhura për gjykim dhe të gjykuara, mosfunksionimi i gjykatës me numrin e përcaktuar në organikë në pjesën më të madhe të kohës, infrastruktura e gjykatës, menaxhimi i punëve në gjykatë nga një gjyqtar tashmë i larguar, kushtet materiale të punës që lënë shumë për të dëshiruar, kanë dhënë pasojat e veta në lidhje me këtë tregues. Referuar pretendimeve të gjyqtares në lidhje me ngarkesën në punë, në raportin analitik është pasqyruar se për të provuar pretendimin e akumulimit të ngarkesës në punë rezulton se bashkëlidhur formularit të integruar, bashkëlidhen: Urdhri nr.242 prot., datë 29.07.2014, me të cilën provohet se kërkesëpaditë e regjistruara në periudhën 29.07.2014 deri 31.08.2014 i kanë kaluar në datë 01.09.2014 gjyqtares {...} (Mema). Me procesverbalin e datës 01.09.2014 rezulton se gjyqtares i kanë kaluar në mënyrë të menjëhershme 112 çështje, 11 urdhra ekzekutimi si dhe 3 kërkesa të thjeshta. Më tej rezulton se bashkëlidhur formularit të integruar të gjyqtarit gjendet kërkesa për heqje dorë nga gjykimi (*kërkesë e cila është rrëzuar nga kryetari i gjykatës në datë 03.09.2014*), në të cilën gjyqtarja ka pasqyruar mosdakordësinë e saj në lidhje me përjashtimin e të gjithë trupës gjyqësore nga shorti dhe duke ia kaluar të gjitha çështjet e regjistruara një gjyqtari të vetëm duke iu referuar për këtë qëllim dhe Vendimit Unifikues nr.2, datë 24.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu gjyqtarja ka paraqitur urdhrin nr.12 prot., datë 18.03.2016 për të provuar marrjen e një numri të madh çështjesh pas largimit të gjyqtarit Bari Shyti si dhe urdhrin nr.32 prot., datë 23.05.2017 për të provuar marrjen e çështjeve pas mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarit Genc Sinjari. Më tej gjyqtarja ka paraqitur shkresat me nr.34 prot, datë 10.04.2018, nr.38 prot, datë 10.07.2017 dhe nr.14 prot., datë 09.01.2019 hartuar prej saj, drejtuar Kryetares së Gjykatës dhe Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në të cilën parashtrohet ngarkesa e lartë gjyqtares dhe kërkesa e saj për nevojën e marrjes së masave me qëllim mbarëvajtjen e punëve dhe respektimin e të drejtave të palëve për një proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme si element i procesit të rregullt ligjor.

Në detyrën e vlerësuesit është bërja e analizës së të dhënave statistikore në mënyrë të tillë që të shmangen përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat e burimeve të tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, për 11 çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor, rezulton se çështjet me objekt “kundërshtim veprimesh përmbarimore”, përbëjnë 8 çështje (çështje të pasqyruara në tabelën nr.1 dhe 2), të cilat respektivisht janë gjykuara për 1 vit e 4 muaj e 9 ditë, 1 vit e 2 muaj, 1 vit e 13 ditë, 1 vit e 1 muaj e 14 ditë, 6 muaj e 13 ditë, 7 muaj e 11 ditë⁴⁰, 4 muaj dhe 2 muaj⁴¹, në tejkallim të dukshëm të afatit 20 ditor.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore” neni 610 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ato shqyrtohen *brenda 20 ditëve*, në dhomë këshillimi, dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e afatit deri në 10 ditë sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja « a » të ligjit nr.49/2012;
- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbaruesit gjyqësor dhe lënien e afatit deri në 10 ditë për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave, sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja « b » të ligjit nr.49/2012;
- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t’u dëgjuar në seancë.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, pa përllogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbaruesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji.

Nëse afati ligjor i shqyrtimit të çështjeve me këtë objekt, do të ishte i njëjtë me afatin maksimal që K.Pr.C parashikon për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, përsëri afati brenda të cilit janë shqyrtuar 7 çështjet që i përkasin kësaj kategorie rezulton i tejkaluar në çdo rast pasi ato janë përfunduar për një periudhë kohe e cila fillon nga 2 muaj minimalisht deri në 1 vit e 4 muaj e 9 ditë, ose më një kohë mesatare gjykimi për të 7 çështjet prej rreth 9.7 muaj.

⁴⁰ Të dhënat për kohëzgjatjen e gjykimit për çështjet e pasqyruara në tabelën nr. 1, me nr. rendor 12, 22, 107, 132, 142, 143.

⁴¹ Të dhënat për kohëzgjatjen e gjykimit për çështjet e pasqyruara në tabelën nr. 2, me nr. rendor 6 dhe 12.

Në çështjet me objekt “sigurim padie”, nga 4 çështje, të gjitha janë gjykuar jashtë afatit ligjor pesë ditor, dhe konkretisht kanë përfunduar për 22 ditë, 1 muaj, 20 ditë dhe 1 muaj⁴². Nuk rezultojnë për këto çështje vonesa në shortimin e tyre pasi rezulton se janë shortuar në të njëjtën datë me regjistrimin e tyre në gjykatë. Në këto 4/çështje afati i gjykimit 5/ditor rezulton të jetë tejkaluar nga 14 deri në 24 ditë.

Në Metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të ulët të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjes në periudhën e vlerësimit prej 916 çështjesh, nga të cilat 392 të mbartura nga viti 2018 dhe 524 të regjistruara në vitin 2019, si dhe ka përfunduar 506 çështje. Ngarkesa e lartë parashtruar nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, si shkak për pamundësinë e respektimit të afateve të gjykimit është një e dhënë e cila mbështetet edhe nga të tabelat me të dhëna statistikore të administruara si burim vlerësimi.

Nga shpjegimet e dhëna nga gjyqtarja në seancë dëgjimore, rezultoi se ajo zbatonte të njëjtin rit gjykimi për gjykimin e çështjeve me objekt “kundërshtim veprimesh përmbartimore” sikundër edhe për çështjet e tjera, pa i dhënë atyre përparësi shqyrtimi, me arsyetimin se një detyrim i tillë nuk i buronte nga Ligji 49/2012, pavarësisht se në nenin 69 të tij parashikohet se “*Veprimet e kryerja nga përmbartuesi gjyqësor, në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen sipas parashikimeve të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile.*” Ndërkohë neni 610 parag 3 i K.Pr.C parashikon se :”*Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbartuesin gjyqësor.*” Në rastin konkret është vetë ligjvënësi që i ka dhënë përparësi shqyrtimi këtyre çështjeve. Të njëjtin qëndrim ligjvënësi ka mbajtur edhe në rastin e gjykimit të kërkesave për sigurim padie, të cilat duhet të shqyrtohen brenda 5/ditëve nga momenti i regjistrimit të tyre në gjykatë dhe jo sikundër kundërshton gjyqtarja, brenda 5/ditëve nga marrja e tyre në shqyrtim në seancë gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Kjo analizë logjike, duke shmangur çështje që në rastin konkret nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, në rastin konkret bazohet në :

- 1) Ngarkesën e gjyqtarës si relatore dhe anëtare (në total ka gjykuar 506 çështje si relator dhe 6 çështje si anëtar) ;
- 2) Pamundësinë e respektimit në të gjitha rastet të afatit ligjor 20/ditor sipas nenit 610 të K.Pr.C, për shkak të veprimeve procedurale të nevojshme për t’u kryer në kuadër të gjykimit administrativ, me qëllim respektimin e të drejtave dhe detyrave procedurale të organit publik (personit fizik apo juridik që ofron një shërbim publik) ;
- 3) numrin relativisht të lartë çështjeve të gjykuar jashtë afatit ligjor (gjithsej 11 çështje) në raport me numrin shumë të vogël të çështjeve që duhet të shqyrtohen me përparësi për shkak të këtij afati, në total 15/çështje ;
- 4) kundërshtimet dhe qëndrimet e mbajtura nga gjyqtarja në seancë dëgjimore.

⁴² Tabela nr. 2, numrat rendorë 9,10,11 dhe 13.

Sa më sipër vlerësohet se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton 78%. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Pavarësisht rrethanave konkrete që lidhen me kushtet e punës, numri relativisht i vogël i çështjeve me afat gjykimi (në total 15 nga të cilat 11 jashtë afatit) nuk justifikon një pikëzim maksimal, sepse gjyqtarja duhet të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi në shqyrtimin me përparësi të këtyre çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor si dhe shkaqeve që kanë ndikuar në këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 6 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, duke iu referuar standardit minimal kohor 1 mujor të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010⁴³ të KLD-së, rezulton se nga 491 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 245 prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë 49,8 % të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Gjyqtarja në Formularin e Vlerësimit ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën administrative, ngarkesën e lartë të saj sikurse është pasqyruar edhe më sipër në analizën e treguesit 2.A.a, duke u ndalur kryesisht te aspekti sasior dhe duke argumentuar se gjyqtari administrativ i shkallës së parë duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative, ndërkohë që referuar të dhënave statistikore rezulton se gjyqtarja ka deklaruar se ka gjykuar *dukshëm* mbi normën e caktuar më sipër duke përballuar një ngarkesë të madhe në punë. Gjithashtu, gjyqtarja ka parashtruar se standardet minimale kohore janë të tilla që merren parasysh në rastin e funksionimit të gjykatave në kushte optimale sa i përket numrit të gjyqtarëve jo më pak se 7, sa i përket infrastrukturës, stafit ndihmës, kualifikimit të tij, mirë menaxhimit të situatave të prurjeve të shumta të çështjeve për gjykim.

Gjyqtarja ka argumentuar se të tilla standarde nuk mund të kërkohen në rastin e një gjykate që ka funksionuar në pjesën më të madhe të saj me një numër gjyqtarësh nën organikë, me një infrastrukturë nën standardin e lejuar dhe më një numër të madh çështjesh për gjykim. Në vijim gjyqtarja ka argumentuar se ka gjykuar 506 çështje si relatores, që përbëjnë më shumë se 3-fishi i numrit të gjykimeve 150 të përcaktuara se duhet të gjykohen nga gjyqtari

⁴³Në pikën 5 shkronja "c" të "Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore", miratuar me vendimin e KLD nr. 261/2 të vitit 2010, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative, parashikohet se : " Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë: ...c. Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo me tej se 1 muaj."

administrativ i shkallës së parë, dhe më shumë se 150 gjykime kanë respektuar standardin minimal kohor.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatin mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.C për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, **gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh.** Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues në fuqi.

Respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodi i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim. Referuar afatit 87/ditor të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, **rezulton se nga 491 çështje të gjykuara për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje matematikore, 245 prej tyre ose 46.4 % e çështjeve, kanë përfunduar përtej këtij afati.**

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, sipas një llogaritje vetëm matematikore, përqindja e mësipërme e çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, pikëzohet me 1/pikë. Por, referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në pikëzim maksimal, duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit⁴⁴. Në

⁴⁴ Në Metodologjinë e Pikëzimit, sa i përket këtij treguesi, parashikohet se: "Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e

rastin konkret, sa i përket treguesit sasior të punës së gjyqtarit, rezulton se në vitin kalendarik 2019 gjyqtarja ka përfunduar në total 506 çështje në cilësinë e relatorit, pra 237 % më shumë se treguesi sasior i përcaktuar në Vendimin nr.261/2 të vitit 2010, çka tregon për një numër të lartë çështjesh të përfunduara, pavarësisht ngarkesës, e cila sipas të dhënave statistikore rezulton e lartë pasi për vitin kalendarik 2019 rezultojnë 524 çështje të caktuara si relator dhe 392 çështje të mbartura nga viti i mëparshëm, me një ngarkesë të përgjithshme prej 916 çështjesh, nga të cilat ajo ka përfunduar 506 çështje.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87/ditor dhe jo 1/mujor ;
- b) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 46.4 %;
- c) shkaqeve që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit sikurse është ngarkesa e lartë e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit dhe numri i lartë i çështjeve të mbartura (392 çështje) të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve dhe për pasojë në pamundësinë e respektimit të standardeve orientuese për përfundimin e gjykimit të çështjeve;
- d) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, vit gjatë së cilit gjyqtarja ka përfunduar 506 çështje⁴⁵, pra 356 çështje ose 237% më tepër se standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së,
- e) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësimit është me e gjerë se treguesi i “respektimit të afateve ligjore”, pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 46.4 % të çështjeve jashtë standardit minimal 87/ditor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, si dhe rezulton se gjyqtarja, pavarësisht ngarkesës, ka përfunduar 237 % me tepër çështje se standardi sasior në fuqi.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal

papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.

⁴⁵ Në lidhje me ngarkesën e gjyqtarës {...} rezulton se në çështjet e përzgjedhura me short gjendet e administruar shkresat me nr.34 prot, datë 10.04.2018, nr.38 prot, datë 10.07.2017 dhe nr.14 prot., datë 09.01.2019 hartuar nga subjekti i vlerësimit, drejtuar Kryetares së Gjykatës dhe Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në të cilën parashtrohet ngarkesa e lartë gjyqtarës dhe kërkesa e saj për nevojën e marrjes së masave me qëllim mbarëvajtjen e punëve dhe respektimin e të drejtave të palëve për një proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme si element i procesit të rregullt ligjor. **Evidentohet se kjo shkresë gjendet e administruar në të gjitha dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short.**

kohor në fuqi (1/muaj) sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi për dy nga tre kategoritë e çështjeve. Krahasimi për efekt të vlerësimit, do të bëhet duke iu referuar standardit minimal kohor 87/ditë për çështjet me palë kundërshtare, referuar arsytimit të bërë më sipër në treguesin 2.A.b.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje (i) për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare” është **1 vit e 2 muaj e 7 ditë** (më e gjatë se standardi minimal kohor 87/ditë); (ii) për kategorinë “çështje administrative pa palë kundërshtare” është **18.5 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi prej 1/muaj); dhe (iii) për kategorinë “marrëdhënie pune” është **6 muaj e 4 ditë** (më e gjatë se standardi minimal kohor 87/ditë).

Duke iu referuar arsytimit të mësipërm lidhur me standardin minimal që duhet të gjejë zbatim për gjykimin e të gjitha çështjeve administrative, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për dy nga tre kategoritë e çështjeve, është më e gjatë se afati 87 ditor, duke tejkalluar këtë standard përkatësisht me : (i) 11,5 muaj për çështjet e kategorisë “administrative me palë kundërshtare” dhe me (ii) 3 muaj e 7 ditë për çështjet e kategorisë “marrëdhënie pune”.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit por edhe në kundërshtimet e saj në seancë dëgjimore, gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, ka renditur të njëjtat shkaqe të pasqyruara në kriteret 2.A-a dhe 2.A-b, si aspekti sasior, aplikimin e standardeve minimale kohore në rastin e funksionimit të gjykatave në kushte optimale sa i përket numrit të gjyqtarëve jo më pak se 7, infrastrukturën e gjykatës, stafin ndihmës dhe kualifikimin e tij, mirë menaxhimit të situatave të prurjeve të shumta të çështjeve për gjykim.

Për sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të tre kategoritë, me afatin 87 ditor të pranuar si një standard minimal për një gjykim administrativ, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se ky afat për shumicën e kategorive të çështjeve (2 nga 3 kategori), e cila, sipas Metodologjisë, pikëzohet me 2 pikë. Duke marrë parasysh faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e çështjeve, për pasojë edhe në kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, të dhënat që rezultojnë nga burime e vlerësimit analizohen në mënyrë të integruar, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret gjyqtarja ka renditur një sërë shkaqesh që kanë ndikuar në kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje ndërkohë që referuar treguesit sasior të punës, rezulton se gjyqtarja ka përballuar një ngarkesë punë shumë më të lartë se sa standardi në fuqi, duke tejkalluar këtë të fundit me 356 çështje ose 237%.

KONKLUZIONE:

Mbështetur në të njëjtën analizë si në treguesin më sipër (treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.”), duke konsideruar afatin 87 ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton se koha mesatare është dukshëm më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve, për dy nga tre kategoritë e çështjeve. Pavarësisht kësaj analize matematikore, duke iu referuar treguesit sasior të punës i cili rezulton të jetë tejkalluar me 237 %, si dhe ngarkesës së lartë e cila ka ndikuar në këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet në një nivel më të lartë pikëzimi, duke u pikëzuar me 4 pikë. Në të njëjtin konkluzion do të arrinim edhe nëse do të prananim argumentimet e gjyqtares lidhur me krahasimin e “kohës mesatare të shqyrtimit të çështjeve

kategoria “marrëdhënie pune” me afatin 6/mujor si standard kohor orientues kohor për gjykimin e këtyre çështjeve nga gjykata civile dhe jo ajo administrative.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve për gjykimin administrativ, por ndërkohë gjyqtarja ka përballuar një volum të lartë punë duke tejkaluar treguesin sasior në fuqi me 237 %, dhe për këtë arsye duhet të pikëzohet me 4 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik, është 97 % (96.56 %).

Në Formuarin e Vlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se në rendimentin e përfundimit të çështjeve kanë ndikuar ngarkesa e lartë në punë. Sa i përket ngarkesës në punë, sipas të dhënave statistikore, rezulton se gjyqtarës në vitin 2019 i janë caktuar 524 çështje, ndërkohë që ka pasur edhe 392 çështje të mbartura nga viti 2018, duke rezultuar me një ngarkesë të përgjithshme prej **916 çështjesh**.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme (97 %) pikëzohet me 8/pikë. Referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 150 çështje. Gjyqtarja rezulton se, pavarësisht ngarkesës së lartë me 916 çështje, gjatë vitit 2019 ka përfunduar në total 506 çështje, pra 237 % më shumë se treguesi sasior në fuqi.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2019, 506 çështje, pra 356 çështje ose 237% më tepër se standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së⁴⁶, vlerësohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtarja, pavarësisht se rezulton të jetë 97 %, duhet të pikëzohet me 10 pikë referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarës lidhen me ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit.

⁴⁶ Në “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, lidhur me standardin sasior të punës, në pikën 3 shkronja “c” parashikohet se :” Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë:.. c. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrativ, jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se në lidhje me këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 10 pikë, pasi rendimenti prej 97 % i përfundimit të çështjeve ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (506 çështje të përfunduara me vendim, ose 237 % më shumë se standardi sasior i punës).

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 42 pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

Në çështjet e kategorisë “administrative me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 7.1 ditë;

Në çështjet e kategorisë “administrative pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 3.9 ditë;

Në çështjet e kategorisë “marrëdhënie pune” koha mesatare e arsytimit të vendimit është 8.09 ditë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se treguesi koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, duhet të analizohet në përputhje me kriterin e ngarkesës në punë, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, infrastrukturën e gjykatës, duke i vlerësuar si pengesa që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton :

- tejkalimi i afatit procedural 7/ditë për kategorinë e çështjet “administrative me palë kundërshtare” është me 0.1 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pa konvertueshëm në një ditë të plotë.
- në çështjet e kategorisë “administrative pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është më e shkurtër se afati 7 ditor;
- tejkalimi i afatit 7 ditë në kategorinë “marrëdhënie pune” me 1.01 ditë, edhe ky një tregues tepër i ulët duke marrë parasysh edhe faktin që për disa çështje në afatin e arsytimit përfshihen edhe dy ditët e pushimit javor, duke bërë që vendimi të jetë dorëzuar ditën e parë të punës.

Nga ana tjetër, afati 7 ditor i arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar i përcaktuar në nenin 42 pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është shumë i shkurtër krahasuar me afatin 20 ditor të arsytimit për vendimet gjyqësore civile sipas parashikimeve të nenit 308, pg. 2 i Kodit të Procedurës Civile (pas ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017). Edhe pse ligji nr. 49/2012 përbën ligj të posaçëm dhe sipas nenit 1 pika 2 të tij, dispozitat e K.Pr.C zbatohen vetëm në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në të, përsëri duket se pas ndryshimeve të K.Pr.C dhe shkaqeve që kanë çuar ligjvënësin në përcaktimin e afatit 20 ditor të arsytimit të

vendimit gjyqësor, ka një mungesë harmonizimi mes qëllimit të parashikimit të këtij afati me afatin e arsyetimit të parashikuara në ligjin nr.49/2012.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, vlerësohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor për të tre kategoritë e çështjeve duhet të konsiderohet e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, pasi tejkalimi i këtij afati nga 0,1 deri në 1.01 ditë, është i papërfillshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues duhet të pikëzohet me 15 pikë.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe të dhënave që pasqyrohen në raportin analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, të dhënat e analizuarat i referohen 5 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim të cilat janë çështje me palë kundërshtare. Referuar Raportit Analitik, rezulton se për 5 çështjet e shqyrtuara, numri i seancave gjyqësore është 22 dhe numri mesatar i tyre rezulton të jetë 4.4 seanca.

Gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se në varësi të kompleksitetit të çështjes, numri i seancave gjyqësore është 3 ose më i vogël se 3. Numri më i madh se 3 seanca gjyqësore përgjithësisht është kushtëzuar nga kompleksiteti i çështjes, numri i madh i palëve, vështirësitë në lidhje me njoftimet, mosparaqitja e ekspertit, nevoja për të plotësuar aktin e ekspertimit, etj.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore jo produktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Sa i përket numrit të seancave gjyqësore për çështje dhe shkaqeve të shtyrjes së tyre rezulton se për 4⁴⁷ nga 5 çështjet e vëzhguara janë zhvilluar përkatësisht 3, 13, 2 dhe 4 seanca gjyqësore. Njoftimet për veprimet paraprake nuk ndikojnë në numrin e seancave gjyqësore, pasi për seancat gjyqësore njoftimet rezulton të jenë kryer dhe administruar rregullisht në dosjet e vëzhguara.

⁴⁷ Për çështjen e përfunduar me vendimin nr. 391, datë 14.05.2019 nuk ka seanca gjyqësore pasi çështja është pushuar në seancë përgatitore.

- Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe të ndryshme. Konkretisht evidentohet se disa seanca nuk janë zhvilluar për shkak se gjyqtarja ka qenë me raport mjekësor apo ka qenë në mbledhje të KED, disa seanca janë shtyrë me qëllim shpalljen e vendimit të arsyetuar (*me argumentimin e ngarkesës në punë apo nevojës për ta vlerësuar çështjen në dhomë këshillimi*⁴⁸). Shkaqe të tjera për shtyrjen e seancave kanë qenë për të marrë informacionin e nevojshëm për hetimin e çështjes nga persona të tretë, mosnjohimi i palëve, komunikimin e kërkesës për shtesë të objektit të padisë dhe shtimin e ndërgjyqësisë, konform neneve 185/2 dhe 161/c të K.Pr.Civile, lënien kohë ekspertit për hartimin e aktit të ekspertimit apo shtesës së tij. Disa seanca të tjera janë shtyrë me kërkesë të palëve, për të disponuar në lidhje me kërkesën për përjashtimin e ekspertit, për shkak të përcaktimit të vlerës së pretenduar nga pala paditëse për efekt të pagimit të taksës, komunikimin e palëve në mungesë të ndryshimit të objektit të padisë dhe për të dhënë kohë palës paditëse për të paraqitur provat shkresore, si dhe dhënien kohë palëve për të paraqitur konkluzionet përfundimtare me shkrim.
- Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale, përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla (*afati 5 ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar, afati 5 ditor për shpalljen e vendimit të arsyetuar*). Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave për kryerjen e veprimeve përgatitore, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, konstatohet **përgjithësisht** respektimi i afatit ligjor për caktimin e seancave (*afati 7 ditor për zhvillimin e veprimeve paraprake sipas parashikimeve të nenit 25 të Ligjit nr.49/2012, afati 15 ditor për caktimin e seancës gjyqësore sipas nenit 27 të Ligjit nr.49/2012, afatet 10 ditore për dhënien kohë palës paditëse për plotësimin e të metave dhe palës së paditur për paraqitjen e prapësimeve dhe provave pas njoftimit të padisë*).
- Konstatohet se nga ana e gjyqtarës, në disa raste, me qëllim shmangien e seancave joproductive i është bërë me dije ekspertit se mos depozitimi i aktit të ekspertimit do të shoqërohet me gjobë⁴⁹. Në rastin kur gjyqtarja ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për t’ju drejtuar me shkrim palës së paditur për të sjellë aktet e ka paralajmëruar se do të merren masa administrative nëse rast mosparaqitje⁵⁰.

KONKLUZIONE:

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-productive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 5 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.4 seanca dhe gjyqtarja përgjithësisht ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Seancat gjyqësore rezultojnë të jenë shtyrë për shkaqe procedurale dhe të përligjura, por numri i tyre në disa raste është kushtëzuar nga kompleksiteti i gjykimit.

⁴⁸ Shih dosjen 2,3,5 dhe 6

⁴⁹ Seanca datë 09.10.2018, dosja që i përket vendimit nr. 981, datë 21.10.2019.

⁵⁰Seanca datë 21.11.2018, dosja që i përket vendimit nr. 981, datë 21.10.2019.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 4.4 seanca dhe gjyqtarja ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi në çdo rast brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e shortit në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.49/2012. Në 5 dosjet e vëzhguara për çështjet me palë kundërshtare, rezulton se veprimet përgatitore, sipas parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, janë zhvilluar brenda harkut kohor nga 2 deri në 7 ditë nga momenti i shortimit.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1 të Ligjit nr.49/2012 duke disponuar për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen brenda afatit ligjor 10 ditor në sekretarinë gjyqësore të prapësimeve me shkrim, të listës së personave që i padituri kërkon të thirret në gjykim me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre si dhe akteve të plota shkresore, në të cilat është bazuar kryerja e veprimit administrativ sipas nenit 25/1/b të ligjit 49/2012. Gjyqtarja e shoqëron disponimin dhe me njoftimin dhe paralajmërimin se në rast të mosparaqitjes së provave nga i padituri shqyrtimi i çështjes do të vazhdojë vetëm me aktet e paraqitura, ndërkohë që shkelja e detyrimit për të paraqitur prova përbën shkak për caktimin e gjobës ndaj titullarit të organit publik. Në 3 nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë administruar njoftimet e dërguara palëve sipas disponimeve të bëra në veprimet e para përgatitore.

Veprimet e dyta përgatitore, sipas nenit 25 të ligjit nr. 49/2012, të cilat zhvillohen pas komunikimit të padisë palës së paditur dhe kalimit të afatit 10/ditor për të paraqitur prapësime me shkrim dhe provat përkatëse, rezulton të jetë zhvilluar pas një kohe relativisht të gjatë, e cila në shumicën e rasteve është mbi 1/vit⁵¹. Në këtë veprime, relatohet se është urdhëruar kryerja e veprimit procedural të njoftimit të akteve dhe nuk ka akte të depozituara nga palët, ndërkohë që në 3 nga 6 dosjet e vëzhguara, njoftimet e urdhëruara në veprimet përgatitore fillestare nuk administrohen në dosje.⁵²

⁵¹ -Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 391, datë 14.05.2019, veprimet e para përgatitore janë kryer më datë 13.02.2018 ndërsa veprimet përgatitore të dyta janë kryer më datë 22.02.2019; -Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 737, datë 31.07.2019, veprimet e para përgatitore janë kryer më datë 27.11.2018 ndërsa më datë 28.05.2019 është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore. -Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 891, datë 21.10.2019, veprimet e para përgatitore janë kryer më datë 05.07.2017 ndërsa veprimet përgatitore të dyta janë kryer më datë 11.06.2018. -Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 972, datë 07.11.2019, veprimet e para përgatitore janë kryer më datë 22.01.2018 ndërsa veprimet përgatitore të dyta janë kryer më datë 20.05.2019. -Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 285, datë 17.04.2019, veprimet e para përgatitore janë kryer më datë 22.09.2017 ndërsa veprimet përgatitore të dyta janë kryer më datë 18.09.2018.

⁵² -Në çështjen që i përket vendimit nr. 391, datë 14.05.2019, nuk administrohen në dosjen njoftime sipas urdhërimit të gjykatës në veprimet përgatitore të datës 13.02.2018; -Në çështjen që i përket vendimit nr. 737, datë 31.07.2019, nuk administrohen në dosjen njoftime sipas urdhërimit të gjykatës në veprimet përgatitore të datës 27.11.2018; -Në çështjen që i përket vendimit nr. 972, datë 07.11.2019, nuk administrohen në dosjen njoftime sipas urdhërimit të gjykatës në veprimet përgatitore të datës 22.01.2018;

Pas kalimit të një afati kohor të gjatë, si në rastet kur njoftimet e palëve për paraqitjen e prapësimeve janë administruar në dosje ashtu edhe në ato raste kur këto njoftime nuk administrohen, gjyqtarja ka zhvilluar veprimet e dyta përgatitore, duke disponuar për caktimin e seancës përgatitore duke evidentuar shkakun për caktimin e seancës përgatitore apo ka disponuar për caktimin e seancës gjyqësore, kur nuk ka qenë e nevojshme që të zhvillohej seancë përgatitore⁵³.

Në një çështje e cila i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare, me objekt “Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”, seanca për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi është caktuar 1 ditë pas zhvillimit të veprimeve përgatitore nga gjyqtarja dhe ka përfunduar po brenda së njëjtës ditë.

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relatimin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Në rastet kur seanca përgatitore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, gjyqtarja, pasi ka dëgjuar palën paditëse, ka relatuar prapësimet me shkrim të paraqitura nga të paditurit dhe provat shkresore që janë paraqitur nga pala në mungesë, duke disponuar me vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë. Në seancë përgatitore janë shqyrtuar dhe është disponuar me vendime të ndërmjetme për kalimin procedural⁵⁴, vendim për t’ju drejtuar palës së paditur me qëllim sjelljen e informacionit në lidhje me arsyet e refuzimit të regjistrimit të pasurisë objekt gjykimi⁵⁵, vendim për shtimin e ndërgjyqësisë konform nenit 161/c të K.Pr.Civile⁵⁶, vendim për shtimin ose pakësimin e objektit të padisë konform nenit 185 të K.Pr.Civile⁵⁷, vendim për marrjen e provës me ekspert, konform nenit 224/a të K.Pr.Civile⁵⁸, vendim për thirrjen e personit të tretë bazuar në nenin 193 të K.Pr.Civile⁵⁹.

Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.C, në çështjet me palë kundërshtare, gjyqtarja ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, e cila në 4 çështjet e vëzhguara⁶⁰ është caktuar jashtë afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27, pika 1 të ligjit nr. 49/2012. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të ligjit nr.39/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, përgjithësisht mbajtur me regjistrim audio. Në rastet kur seanca nuk është zhvilluar në sistem audio është pasqyruar shkakun i mungesës së sallave, në të cilat është instaluar sistemi audio. Seancat gjyqësore rezultojnë të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.C dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo të dijeni për palët që nuk janë paraqitur; disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa

⁵³ Dosja që i përket vendimit nr. 737, datë 31.07.2019.

⁵⁴ Çështja që i përket vendimit nr. 391, datë 14.05.2019

⁵⁵ Çështja që i përket vendimit nr. 391, datë 14.05.2019

⁵⁶ Çështja që i përket vendimit nr. 891, datë 21.10.2019

⁵⁷ Çështjet që i përkasin vendimeve nr. 891, datë 21.10.2019, nr. 972, datë 07.11.2019 dhe nr. 285, datë 17.04.2019

⁵⁸ Çështja që i përket vendimit nr. 391, datë 14.05.2019

⁵⁹ Çështja që i përket vendimit nr. 285, datë 17.04.2019

⁶⁰ Çështjet që i përkasin vendimeve me nr. 737, datë 31.07.2019, nr. 891, datë 21.10.2019, nr. 972, datë 07.11.2019 dhe nr. 285, datë 17.04.2019

shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit; dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare duke i dhënë kohë sipas afatit procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.C; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar ose shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar⁶¹, përgjithësisht brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 42 pika 2 të ligjit nr. 49/2012.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat e palëve lidhur me ndërgjyqësinë, saktësimin e objektit të padisë, shtyrjen e seancës, caktimin e detyrave të ekspertit, etj.*).

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesa të papërfillshme, shoqëruar me relatimin e shkakut që ka shkaktuar vonesën. Veprimet përgatitore dhe seancat përgatitore janë dokumentuar rregullisht dhe në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore ndërsa jo të gjitha seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio me argumentimin e mungesës së sallave ku të jetë instaluar sistemi audio.

Sa i përket distancës kohore në kryerjen e veprimeve përgatitore, sipas parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012 gjyqtarja në vetëvlerësim por edhe në kundërshtimet e saj ka parashtruar se radha e vënies në lëvizje e çështjeve ka pasur si kriter kohën e regjistrimit të padisë, duke filluar nga ajo më e hershmja, si dhe natyrën e mosmarrëveshjes, duke i dhënë përparësi mosmarrëveshjeve në fushën e sigurimeve shoqërore për shkak të natyrës vulnerabël të subjekteve të përfshira në të tilla mosmarrëveshje.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja nuk ka kryer në çdo rast me efikasitet veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Kjo pasi në 4 nga 5 dosjet e vëzhguara rezulton se veprimet përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, pas urdhërimit të njoftimit të padisë palës së padituri, janë zhvilluar pas një kohe relativisht të gjatë, e cila në disa raste kalon 1 vit, dhe në 3 nga këto 4 dosje mungojnë njoftimet për palët sa i përket urdhërimeve të gjykatës të dokumentuara në procesverbalin e veprimeve të para përgatitore. Veprimet procedurale në seancë përgatitore dhe gjyqësore, janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke respektuar përgjithësisht afatet procedurale për zhvillimin e tyre (me disa raste përjashtimore ku këto afate janë tejkaluar me disa ditë) si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Shkalla e kujdesit të gjyqtarës për të kryer veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit

⁶¹ Çështjet që i përkasin vendimeve me nr. 737, datë 31.07.2019, nr. 891, datë 21.10.2019, nr. 972, datë 07.11.2019 dhe nr. 285, datë 17.04.2019

gjyqësor efektive dhe në kohë, nuk është e njëjtë referuar 3 fazave : veprime përgatitore, seance përgatitore dhe seancë gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Mesatare” dhe pikëzohet me 12 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se 5 nga 6 dosjet nuk janë renditura sipas një rregulli të caktuar. Në disa prej dosjeve të vëzhguara, aktet e gjykatës rezultojnë të mos jenë të grupuara sipas llojit, por të renditura sipas momentit të hartimit të tyre, duke krijuar vështirësi në orientimin e lexuesit. Në disa raste renditja e akteve bëhet sipas një rendi kronologjik, sipas datës së paraqitjes ose hartimit të aktit.

Pavarësisht se nuk ka një rregull të mirë përcaktuar për mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, gjyqtari ka liri veprimi për ta përcaktuar atë gjithmonë në funksion të lehtësisë së shfrytëzimit të dosjes nga lexuesi dhe gjykata më e lartë. Në rastin konkret, mënyra e renditjes së akteve në dosjet e vëzhguara, në disa prej tyre, duke mos ndjekur të njëjtin rregull logjik, kronologjik ose të kombinuar (pra duke renditur aktet sipas kategorisë së bashku dhe sipas datave brenda secilës kategori) krijon në disa raste dhe kryesisht në dosjet voluminoze, vështirësi në akses për lexuesin.

Pavarësisht detyrave të përcaktuara në ligjin procedural për sekretarin gjyqësor, është gjithashtu Ligji, neni 74 pika 5 e Ligjit për Statusin, që përcakton si tregues për vlerësimin e aftësive organizative të gjyqtarit, aftësinë e tij për të administruar dosjet gjyqësore nëpërmjet treguesit të rregullshmërisë. Dosja gjyqësore krijohet nga sekretari gjyqësor (referoju nenit 44 të Ligjit 98/2016), por mbikëqyrja e procesit të mbajtjes së tyre sipas një rregulli të caktuar i takon gjyqtarit. Pas krijimit të dosjeve gjyqësore, sekretari gjyqësor kryen çdo detyrë që i ngarkohet nga gjyqtari në lidhje me administrimin e procesit gjyqësor. Në mungesë të një akti të unifikuar për të gjitha gjykatat për mënyrën se si duhet të renditen aktet në një dosje gjyqësore, rendin e renditjes e përcakton gjyqtari, duke pasur si qëllim shfrytëzimin lirisht të saj nga çdo lexues dhe gjykata më e lartë.

KONKLUZIONE:

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara por mënyra e renditjes së tyre, në disa prej dosjeve, krijon vështirësi në akses për lexuesin, çka tregon për një shkallë jo të lartë mbikëqyrjeje të këtij procesi nga ana e gjyqtarës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 4 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik rezulton se në dosje jo gjithmonë ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Nga vëzhgimi i 6 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim sa i përket saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e paraqitura nga palët (padia, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet e palëve kur ato janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (shkresa të gjykatës drejtuar institucioneve, shkresa të gjyqtarës drejtuar kryetarit të gjykatës lidhur me ngarkesën në punë, procesverbalet e çdo seancë të zhvilluar në dhomë këshillimi, seancë përgatitore dhe gjyqësore, vendimet gjyqësore, procesverbali audio kur seancat janë zhvilluar me sistem audio). Ndërsa në lidhje me njoftimet, në 3 prej dosjeve të vëzhguara, mungojnë njoftimet drejtuar palëve dhe Avokaturës së Shtetit të urdhëruara për tu kryer pas veprimeve të para përgatitore të kryera nga gjyqtarja në dhomë këshillimi⁶². Në veprimet e dyta përgatitore, në këto 3 dosje, gjyqtarja ka vlerësuar se këto veprime janë kryer, pa u shprehur lidhur me datën e marrjes dijeni nga pala së cilës i është drejtuar njoftimi, ndërkohë që këto akte mungojnë në dosjen gjyqësore.

Në kundërshtimet e saj gjyqtarja pretendoi se nuk është përgjegjësi e saj kryerja e njoftimeve dhe as mbikëqyrja e realizimit të tyre. Por sikundër u analizua më lart treguesi i plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit, është tregues vlerësimi për aftësitë organizative të gjyqtarit. Ndryshe nga sa pretendoi gjyqtarja në kundërshtimet e saj dhe në seancë dëgjimore, ecuria procedurale e çështjes, në 3 nga dosjet e vëzhguara ishte e tillë që tregonte kryerjen e njoftimeve, pavarësisht se nuk pasqyrohej data e dërgimit të njoftimit apo ajo e marrjes së njoftimit nga pala së cilës i drejtohej. Mbetet e paqartë kryerja ose jo e njoftimeve, por mungesa e tyre në dosjet gjyqësore u pranua prej gjyqtarës.

Nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, përveç shkresave të gjyqtarës drejtuar kryetarit të gjykatës në lidhje me ngarkesën në punë, të cilat nuk vlerësohen të jenë akte që nuk i përkasin çështjes, pasi kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve dhe janë vlerësuar nga gjyqtarja me vend për t'u administruar në secilën dosje.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë. Nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete, por në tre raste konstatohet mungesë e njoftimeve drejtuar palëve lidhur me veprimet e para përgatitore të kryera nga gjyqtarja në dhomë këshillimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “mbi mesataren” dhe pikëzohet me 8 pikë.

KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

⁶² -Në çështjen që i përket vendimit nr. 391, datë 14.05.2019, nuk administrohen në dosjen njoftime sipas urdhërimit të gjykatës në veprimet paraprake të datës 13.02.2018; -Në çështjen që i përket vendimit nr. 737, datë 31.07.2019, nuk administrohen në dosjen njoftime sipas urdhërimit të gjykatës në veprimet paraprake të datës 27.11.2018; -Në çështjen që i përket vendimit nr. 972, datë 07.11.2019, nuk administrohen në dosjen njoftime sipas urdhërimit të gjykatës në veprimet paraprake të datës 22.01.2018;

Pikët	Niveli i vlerësimit
79	Shumë mirë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për gjyqtaren {...} (Mema), gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Referuar raportit analitik, gjatë periudhës së vlerësimit, për gjyqtaren {...} janë trajtuar nga ILD, 2 ankesa për të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar.

Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

Ankesa e shtetasit E.Zh - Shtetasi E.Zh, ka depozituar në KLGJ me nr. 2874 prot, datë 24.05.2019 ankesë ndaj gjyqtares {...}mi. Kjo ankesë është regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr. 1107 prot, datë 15.6.2020. Referuar përmbajtjes, ankesa konsiston në pretendimet për shkeljen e nenit 72 të K.Pr.Civile pasi, sipas ankuesit, çështja gjyqësore nuk ka qenë në fazën fillestare të gjykimit, dhe si e tillë referuar nenit 66/1 të ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative” i takon të njëjtit gjyqtar që ka dhënë vendimin e themelit të urdhërojë kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre. Gjithashtu ankuesi E.Zh ka pretenduar se në kundërshtim me nenin 16 të K.Pr.Civile të gjithë gjyqtarët e gjykatës administrative nuk kanë bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe se janë dorëhequr nga një çështje për të cilën e njëjta gjykatë ka dhënë vendimin e pushimit.

ILD, pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, ka vlerësuar se pretendimet e ankuesit janë të natyrës që zgjidhen mbi bazën e apelimit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë dhe ka vendosur arkivimin e ankesës ndaj veprimtarisë së gjyqtares {...} me vendimin nr. 1107/3 prot, datë 22/12/2020 duke arsyetuar se: “...Nga të dhënat e marra pranë gjykatës, vendimi për pranimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i gjyqtares {...}, si vendim i cili ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar, nuk rezulton të jetë cënuar nga një gjykatë më e lartë. Ndërkohë që kërkesa për heqje dorë paraqitur nga ish-kryetarja e gjykatës është rrëzuar nga Kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me vendimin nr.274/21 prot, datë 10.06.2019, pra nuk rezulton që gjyqtarët të jenë përjashtuar njëri pas tjetrit. Gjyqtarja Marjana Velçani ka vijuar gjykimin e çështjes së ankuesit. Në vijim rezulton se është paraqitur sërish e njëjta kërkesë, e cila është gjykuar nga gjyqtari Ergys Gashi dhe është

pushuar. Ndaj këtij magjistrati nuk ka pretendime. Përsa më sipër, referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara, rezultojnë se duke qenë të natyrës që zgjidhen mbi bazën e apelimit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, nuk rezulton që dorëheqja e gjyqtarës {...} të jetë cenuar, ndërsa gjyqtarës Marjana Velçani nuk i është pranuar dorëheqja. Asnjë prej pretendimeve të ankuesit nuk rezulton të jetë me natyrë disiplinore, të parashikuara shprehimisht në nenet 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për rrjedhojë vlerësohet se ankesa nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, kjo referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara dhe parashikimeve të nenit 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ankesa e dytë e depozituar me shkresën me nr.2285 prot., datë 18.04.2019 pranë KLGJ nga shtetasi M.Sh, më datë 18.04.2019, është përcjellë pranë Zyrës së ILD duke u regjistruar me nr. 1073 prot, datë 10.06.2020. Ankuesi ka pretenduar se gjyqtarja {...} (Mema) nuk duhej të gjykonte çështjen pasi ankuesi si palë e tretë në proces i kishte paraqitur në seancë vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe ka pretenduar se kjo gjykatë e ka gjykuar njëherë këtë çështje duke kërkuar në thelb pushimin e gjykimit. ILD, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka vendosur me vendimin nr.1073/3 prot., datë 24.12.2020 për arkivimin e ankesës së ankuesit M.SH ndaj veprimtarisë së magjstrates {...} (Mema) me arsyetimin: “...Pretendimet që parashtrohen në ankesë janë pretendime që lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes dhe si të tilla ato zgjidhen mbi bazën e apelimit gjyqësor vetëm nga gjykata më e lartë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të marrë atributet e gjykatës më të lartë dhe të kontrollojë apo ndryshojë vendimmarrjen e saj. Po kështu nga vendimi i dhënë nga gjyqtarja {...} me nr.455, datë 11.05.2017 nuk rezulton që ankuesi të jetë cenuar, pasi gjyqtarja ka vendosur rrëzimin e padisë dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë. Pra, akti administrativ i nxjerrë në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nuk është cenuar. Natyra e pretendimeve të ankuesit ndaj gjyqtarës {...} nuk rezulton të jetë me natyrë disiplinore, të parashikuara shprehimisht në nenet 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sa më sipër vlerësohet se ankesa e ankuesit M.SH referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara, nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë referuar nenit 120 pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””, i ndryshuar. Për këtë shkak ankesa duhet të arkivohet në zbatim të nenit 121 pika 2 shkronja “a” të këtij ligji.”

Në tërësi, të dy ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës në periudhën e vlerësimit, pasi janë verifikuar nga ILD, nuk rezulton të kenë elementë, të cilët mund të cenojnë etikën në punë të gjyqtarës, pasi pretendimet e ankuesve lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit apo zgjidhjen në themel të çështjes, e cila është objekt i kontrollit vetëm nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit nga gjykata më e lartë.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit i ka vlerësuar shumë të larta aftësitë e saj në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONE:

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarës, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e

vlerësimi për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jetë regjistruar dy ankesa, trajtuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 1107/3 prot, datë 22.12.2020 dhe nr. 1073/3 prot⁶³, datë 24.12.2020 më të cilët është disponuar për arkivimi e tyre, pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se nuk plotësojnë kushtet e provueshmërisë, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna apo indicje që të dëshmojnë për shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu nuk rezulton që ndaj gjyqtarës {...} (Mema), gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar asnjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 197/24 prot. datë 29.06.2020, lidhur me deklarin e pasurisë, konkludohet se: “*Deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarin të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit*”.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojnë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarës.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarës, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues pasi

⁶³ Vendimet për verifikimin e ankesave janë dërguar nga ILD me shkresën me nr. 2437/22 prot, datë 28.12.2020.

presumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duhet të pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, për gjyqtaren {...} ka pasur 7 kërkesa për përjashtim, nga të cilat 6 janë rrëzuar, ndërsa 1 kërkesë është pranuar. Po sipas të dhënave statistikore rezulton se gjyqtarja ka hequr dorë nga shqyrtimi i 10 çështjeve gjyqësore, nga të cilat 9 kërkesa janë pranuar dhe 1 kërkesë është rrëzuar.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka deklaruar se nga shtatë kërkesa të paraqitura për përjashtimin e saj, vetëm një rezulton të jetë pranuar, ndërkohë që të tjerat janë rrëzuar si pa mbështetura në prova dhe në ligj. Gjithashtu, gjyqtarja ka argumentuar se numri i kërkesave të paraqitura për përjashtim është i pa konsiderueshëm në raport me numrin e madh të çështjeve për shqyrtim.

Në tërësi, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim (*vetëm një kërkesë është pranuar*), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër rezulton të jetë i pa konsiderueshëm.

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...} (Mema), gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilat pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Në lidhje me këtë kriter rezulton se gjyqtarja ka vlerësuar se ka aftësi shumë të larta për të qenë transparente, e qartë në shpjegim si me palët dhe subjektet e tjera, në vendime dhe në drejtimin e procesit gjyqësor, procesverbalet e seancave gjyqësore të mbajtura me shtypshkrim apo ato audio (*për aq sa ka qenë e mundur të aplikohet ky sistem*), ku evidentohet gjuha e qartë, e kuptueshme dhe koncize në komunikimin.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësi në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtarja vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicje për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se i ka dhënë gjithmonë rëndësi komunikimit, duke e vlerësuar si të rëndësishëm në ngritjen profesionale të një juristi, dhe shumë të nevojshëm dhe produktiv në punë e një prakticioneri.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se për shkak të pozicionit si zëvendëskryetare është përpjekur në nxitjen e bashkëpunimit dhe krijimin e një ambienti pune harmonik dhe produktiv, pasur parasysh dhe vështirësitë që ka sjellë në Gjykatë mbingarkesa e madhe në punë.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtarja {...} (Mema), gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, ka marrë pjesë në 3 aktivitete trajnuese, pjesë e Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3 të Ligjit për Statusin, *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtarja ka marrë pjesë në 3 aktivitete trajnuese të shtrira në 6 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës administrative dhe gjykimit administrativ.

KONKLUZIONE:

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 3 aktivitete

trajnuese të shtrira në 6 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara në Ligjin për Statusin.

***Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh. M është 6 ditë në vit (brenda kufijve ligjore 5-40 ditë në vit), duke u pikëzuar me 20 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe dosjes personale të gjyqtarës {...}, nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues.

Referuar informacionit të përcjellë nga Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 537/1, datë 05.08.2020, nuk rezultojnë të dhëna që gjyqtarja të ketë marrë pjesë me cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit për trajnimin e gjyqtarëve, në periudhën e vlerësimit viti 2019.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit ka deklaruar se pranë gjykatës në të cilën ushtron funksionin nuk ka magjistratë të caktuar për të ushtruar stazhin profesional. Ndërsa në lidhje me pjesëmarrjen si trajnues/ekspert/lehtësues përgjatë vitit 2019, gjyqtarja ka deklaruar se nuk ka pasur të tillë eksperiencë duke shpjeguar se ngarkesa e madhe në punë që përballojnë gjykatat administrative në përgjithësi dhe ajo e Durrësit, e bën të vështirë pjesëmarrjen në të tilla angazhime. Gjithashtu gjyqtarja ka deklaruar se viti 2019 ka qenë një vit i ngarkuar për shkak të angazhimit të saj intensiv në KED përgjatë pjesës së parë të vitit, Janar –Korrik 2019, si dhe përfshirjes në procedurë të përshpejtuar të rivlerësimit.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se pikëzimi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë, dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

KONKLUZIONE:

Sa më sipër, për gjyqtaren {...} (Mema), duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për përfshirjen e saj në listën e ekspertëve/lehtësuesve të trajnimit vazhdues pranë Sh.M dhe angazhimin konkret të saj në këto cilësi në aktivitet trajnuese, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

***Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen e gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka deklaruar se ka marrë pjesë në një organ kolegjal kushtetues si Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke marrë pjesë mbledhjet e këtij organi të zhvilluara përgjatë periudhës Janar –Korrik 2019, qëllim i të cilave ka qenë hartimi i rregulloreve dhe akteve të tjera me karakter të përgjithshëm, mbi bazën e të cilave ka funksionuar KED 2019 dhe po vijon të funksionojë KED 2020.

Sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Lartë⁶⁴, pranë së cilës ushtron veprimtarinë KED, rezulton se në periudhën Janar-Qershor 2019 gjyqtarja {...} ka marrë pjesë në 15 mbledhje, procesverbalet e të cilave janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës, në seksionin e veprimtarisë së KED. Sipas përmbajtjes së procesverbaleve, rezulton se gjyqtarja {...}, në cilësinë e anëtarit zëvendësues, ka marrë pjesë në mbledhjet e KED të zhvilluara në periudhën Janar- Qershor 2019, duke marrë pjesë në diskutime lidhur me aktet nënligjore të miratuara⁶⁵, si dhe në diskutime të tjera me karakter procedural.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi, pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, prandaj të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke vlerësuar jo anëtarësinë por kontributin e gjyqtarës {...} si anëtare zëvendësuese në KED, në hartimin, diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore, për të ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

⁶⁴ Informacioni është dërguar nga Gjykata e Lartë nëpërmjet postës elektronike më datë 22.02.2021

⁶⁵ Sipas procesverbaleve të mbledhjeve rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në diskutime për miratimin e akteve nënligjore të tilla si :

- Projekt rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi” ;
- Projektvendim mbi Procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion;
- Projektvendim për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë ;
- Shpallja për hapjen e procedurës së aplikimit në pozicionin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë ;
- Projektvendim për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ;
- Projektvendim për njoftimin e Gjykatës së Lartë, si subjekt që e ka vënë në lëvizje Këshillin, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidatëve për dy pozicione vakante në Gjykatën Kushtetuese, etj.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me zero pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarës dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.*

KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	79	Shumë mirë
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	372	Shumë mirë

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} (Mema), pavarësisht ngarkesës së çështjeve, duhet të organizojë punën dhe menaxhojë kohën, duke i dhënë prioritet shqyrtimi, çështjeve për të cilat ligji parashikon afat brenda të cilit ato duhet të gjykohen. Duhet të kryejë me efektivitet dhe në kohë veprimet përgatitore përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit të njoftimeve. Duket t’i kushtojë një shkallë më të lartë kujdesi mbikëqyrjes së renditjes së akteve nga sekretarja gjyqësore, me qëllim që dosja

gjqësore të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme nga lexuesi. Gjyqtarja duhet të mbajë në konsideratë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese që sjellin rritje profesionale dhe formim gjithëpërfshirës. Nisur nga problematikat e hasura në veprimtarinë e përditshme gjyqësore, angazhimi i gjyqtarës duhet të reflektohet edhe në propozimin e temave konkrete të trajnimit në SHM si dhe kryerjen e publikimeve me qëllim zhvillimin e doktrinës në të drejtën administrative.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} (MEMA) PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019- 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë

	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT			
	Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Kundërshtimet e gjyqtares dhe provat e administruara në seancë dëgjimore	31-40 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Kundërshtimet e gjyqtares dhe provat e administruara në seancë dëgjimore	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve

	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi +99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 3 seanca por shkallë e lartë e aftësisë aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të	1. Aktet e dosjeve të	Mesatare

	nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Kundërshtimet e gjyqtares dhe provat e administruara në seancë dëgjimore	
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Kundërshtimet e gjyqtares dhe provat e administruara në seancë dëgjimore	Mbi mesataren
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Kundërshtimet e gjyqtares dhe provat e administruara në seancë dëgjimore	Mbi mesataren
4. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE			
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë

B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL			
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë

	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari 	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera 	Nuk ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen 	Ka të dhëna

		profesionale të gjyqtarit	
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		372	
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		Shumë	

RELAT